VENDIM
Nr. 845, datë 30.12.2025

PËR KRIJIMIN E SHOQËRISË AKSIONARE 'OPERATORI I SHËRBIMEVE TË INTEGRUARA SHËNDETËSORE' SH.A. (OSHISH SH.A.)

(Ndryshuar me VKM nr. 629, datë 30.7.2026)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. *Krijimin e shoqërisë aksionare "Operatori i Shërbimeve të Integruara Shëndetësore" sh.a. (OSHISH sh.a.), me kapital 100% shtetëror, për ofrimin e shërbimeve të integruara të sterilizimit, organizimin, administrimin dhe ofrimin e shërbimeve të Programit Kombëtar të Kontrollit Mjekësor Bazë, si dhe ofrimin e shërbimit të hemodializës në 5 (pesë) qendrat pranë spitaleve Shkodër, Lezhë, Vlorë, Elbasan dhe Korçë.*

2. Shoqëria aksionare *OSHISH* sh.a. ofron, kundrejt pagesës, shërbimet e mëposhtme:

a) ofrimin e seteve të personalizuara të instrumenteve kirurgjikale sterile;

b) furnizimin me material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale;

c) trajtimin e mbetjeve me rrezik biologjik dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale;

ç) menaxhimin dhe administrimin e Stacionit Qendror të Sterilizimit në QSUT;

d) ofrimin e instrumenteve kirurgjikale sipas tipologjisë së ndërhyrjes, të paketuara në set individual për çdo pacient;

dh) menaxhimin e cikleve për ripërpunimin dhe sterilizimin e instrumenteve dhe të materialeve të tjera të ripërdorshme;

e) ripërpunimin e sterilizimin me avull dhe temperatura të ulëta;

ë) furnizimin me veshje sterile salle dhe materiale të ngjashme njëpërdorimshme;

f) trajtimin e mbetjeve spitalore me rrezik biologjik dhe dezinfektimin e ambienteve;

g) digjitalizimin e menaxhimit, të ndjekjes dhe të raportimit të shërbimeve të integruara të sterilizimit.

gj) ofrimin e shërbimeve të Programit Kombëtar të Kontrollit Mjekësor Bazë, si dhe organizimin e administrimin operacional të rrjetit të laboratorëve, të pikave të ofrimit të shërbimit, të proceseve logjistike, të sistemeve informatike, të pajisjeve dhe aseteve të nevojshme për realizimin e programit;

h) administrimin e rrjetit të laboratorëve dhe të pikave të ofrimit të shërbimit, si dhe koordinimin e proceseve logjistike dhe informatike, që lidhen me realizimin e Programit Kombëtar të Kontrollit Mjekësor Bazë;

i) kryerjen e çdo veprimtarie tjetër të nevojshme për zbatimin e Programit Kombëtar të Kontrollit Mjekësor Bazë, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

j) marrjen e masave të nevojshme organizative, teknike, logjistike dhe kontraktore për sigurimin e vazhdimësisë së pandërprerë të shërbimit të hemodializës, në përputhje me protokollet mjekësore të miratuara dhe legjislacionin në fuqi në 5 (pesë) qendrat pranë spitaleve Shkodër, Lezhë, Vlorë, Elbasan dhe Korçë, përfshirë zhvillimin e procedurave të prokurimit, lidhjen, administrimin e monitorimin e zbatimit të kontratave për mirëmbajtjen parandaluese dhe korrigjuese të pajisjeve mjekësore, si dhe për furnizimin me materiale të konsumit, mallra, pajisje, produkte dhe shërbime të tjera të nevojshme për funksionimin e këtij shërbimi, sigurimin e funksionimit normal të aparaturave dhe të pajisjeve mjekësore;

k) administrimin, menaxhimin e mirëmbajtjen e aseteve, të pajisjeve mjekësore, të sistemeve informatike dhe elementeve të tjera pasurore, që përdoren për ofrimin e shërbimeve në fushat e veprimtarisë së shoqërisë.

2/1. OSHISH sh.a. ofron të gjitha shërbimet e parashikuara në shkronjat: "gj", "h", "i", "j" dhe "k", të këtij vendimi, pas përfundimit të afatit të kontratave përkatëse të koncesionit/partneritetit publik privat për kontrollin mjekësor bazë dhe për ofrimin e shërbimit të hemodializës.

3. Kapitali fillestar për krijimin e shoqërisë aksionare *OSHISH* sh.a. është 200 000 000 (dyqind milionë) lekë.

4. Autoriteti publik, që përfaqëson shtetin si pronar të 100% të aksioneve të shoqërisë aksionare *OSHISH* sh.a., është Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

5. Shoqëria aksionare *OSHISH* sh.a. ofron shërbimet e përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi, kundrejt të gjitha spitaleve publike universitare, rajonale dhe bashkiake në Republikën e Shqipërisë, *si dhe institucioneve të kujdesit shëndetësor parësor dhe strukturave të tjera publike shëndetësore, sipas organizimit të Programit Kombëtar të Kontrollit Mjekësor Bazë*.

6. Shoqëria aksionare *OSHISH* sh.a. mund të ofrojë shërbime të tjera shtesë për subjekte publike dhe private, në përputhje me statutin e shoqërisë e legjislacionin në fuqi.

7. *Të ardhurat, që rrjedhin nga shërbimet e ofruara nga OSHISH sh.a. arkëtohen nga shoqëria, në bazë të kontratave të lidhura me institucionet financuese ose përfituese dhe sipas tarifave të miratuara, në përputhje me legjislacionin në fuqi.*

8. *Shoqëria aksionare OSHISH sh.a. financohet nga të ardhurat e gjeneruara nga ofrimi i shërbimeve publike të integruara të sterilizimit, si dhe nga burime të tjera të ligjshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Të ardhurat përdoren vetëm për ushtrimin e zhvillimin e veprimtarisë së saj, duke ruajtur karakterin e shërbimit publik. Për ofrimin e shërbimeve shëndetësore të Programit Kombëtar të Kontrollit Mjekësor Bazë, si dhe ofrimin e shërbimit të hemodializës, OSHISH sh.a., si dhënës shërbimi i licencuar, financohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.*

9. Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, ndjek procedurat e nevojshme për:

a) themelimin e miratimin e statutit të shoqërisë aksionare *OSHISH* sh.a.;

b) regjistrimin e shoqërisë aksionare në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

10. Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale i siguron shoqërisë aksionare *OSHISH* sh.a., mjediset e punës, të nevojshme për fillimin e ushtrimit të veprimtarisë.

11. *Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale i kalon, pa pagesë, shoqërisë aksionare asetet, pajisjet, sistemet informatike, të drejtat dhe çdo element tjetër pasuror, që i kalojnë shtetit pas përfundimit të kontratës të partneritetit publik privat/koncesionit me nr. 1440/40, datë 10.12.2015, "Për ofrimin e shërbimeve të integruara të furnizimit të setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale sterile, furnizimin me material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale, trajtimin e mbetjeve me rrezik biologjik dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale", të ndryshuar, nr. 3082/20, datë 7.1.2015, "Për paketën e shërbimeve të kontrollit mjekësor bazë për grup-moshat 40–65 vjeç", të ndryshuar, si edhe nr. 1503/44, datë 10.2.2016, "Për shërbimin e hemodializës", në përputhje me parashikimet kontraktore dhe legjislacionin në fuqi.*

12. Efektet financiare për zbatimin e këtij vendimi për krijimin e kapitalit fillestar të shoqërisë janë në vlerën 200 000 000 (dyqind milionë) lekë dhe përballohen nga fondet e miratuara të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale për vitin buxhetor 2026, në artikullin 231 (shpenzime kapitale) të programit 07330 "Shërbime të kujdesit dytësor". Injektimi i kapitalit fillestar do të kryhet menjëherë pas regjistrimit të shoqërisë aksionare në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

13. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama